



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “AGS Corporation Sh.P.K. & Portofin d.o.o.” të datës 09.10.2023 kundër njoftimit mbi vendimin të datës 04.10.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizimi me pajisje për pastrimin e kryeqytetit” me nr. të prokurimit 616-23-7016-1-1-1, Komuna e Prishtinës (Autoriteti Kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. REFUZOHET si e pabazuar** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “AGS Corporation Sh.P.K. & Portofin d.o.o.” të datës 09.10.2023 kundër njoftimit mbi vendimin të datës 04.10.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizimi me pajisje për pastrimin e kryeqytetit” me nr. të prokurimit 616-23-7016-1-1-1.
- II. LEJOHET** autoriteti kontraktues që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të këtij vendimi.
- III. NJOFTOHET** operatori ekonomik “AGS Corporation Sh.P.K. & Portofin d.o.o.” se ky aktivitet i prokurimit është kthyer në rivlerësim sipas vendimit të autoritetit kontraktues të datës 09.10.2023 për shkak të kërkesës për rishqyrtim të një tenderuesi tjetër në këtë aktivitet.
- IV. NJOFTOHET** operatori ekonomik “AGS Corporation Sh.P.K. & Portofin d.o.o.” si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- V. Vendimi hyn në fuqi** në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik “AGS Corporation Sh.P.K. & Portofin d.o.o.” (tutje “parashtruesi”) me datë 09.10.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin të datës 04.10.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizimi me pajisje për pastrimin e kryeqytetit” me nr. të prokurimit 616-23-7016-1-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet kryesore të parashtruesit janë cituar si në vijim:

- **“Pika 1.** *Te kamioni per mbeturina 16m3 eshte kerkuar "Hopper capacity minimum 2.0 m3"(shih specifikim teknik ne Dosjen e tenderit).Ne katalogun e siguruar gjate qasjes ne dokumente zyrtare per kete tender prane zyres se prokurimit te KK Prishtine, verejme se OE i propozuar per kontrate ka ofertuar me "Hopper capacity minimum 1.6m3 kurse ne vizatimin teknik te dorezuar verehet qarte se kapaciteti eshte 1.5 m3.Pra kemi mosperputhje te qarte te plotesimit te specifikimeve teknike nga Katalogu dhe vizatimi teknik i ofruar nga OE i propozuar per kontrate, dhe ne asnjeren nga keto 2 dokumente nuk ploteson kriterin teknik – pra OE i propozuar per kontrate eshte i papergjegjshem.*
- **Pika 2.** *Te kamioni per mbeturina 8m3 eshte kerkuar "Hopper capacity minimum 1.3 m3"(shih specifikim teknik ne Dosjen e tenderit).Ne katalogun dhe ne vizatimin teknik te siguruar gjate qasjes ne dokumente zyrtare per kete tender prane zyres se prokurimit te KK Prishtine, verejme se OE i propozuar per kontrate ka ofertuar me "Hopper capacity minimum 1m3.Pra kemi mosperputhje te qarte te plotesimit te specifikimeve teknike nga Katalogu dhe vizatimi teknik i ofruar nga OE i propozuar per kontrate, rrjedhimisht nuk ploteson kriterin teknik - pra OE i propozuar per kontrate eshte i papergjegjshem.*
- **Pika 3.** *Te kamioni per mbeturina 8m3 eshte kerkuar " Additional reservoir in the front part of waste box for collecting drainage water, capacity minimum 140 l", (shih specifikim teknik ne Dosjen e tenderit).Ne katalogun dhe ne vizatimin teknik te siguruar gjate qasjes ne dokumente zyrtare per kete tender prane zyres se prokurimit te KK Prishtine, verejme se OE i propozuar per kontrate ka ofertuar me rezervuar ne kapacitet prej 70 liter, rrjedhimisht nuk ploteson kriterin teknik - pra OE i propozuar per kontrate eshte i papergjegjshem.*
- **Pika 4.** *Ne FDT pika 9 eshte kerkuar si me poshte: Shih Foto:Ne dokumentacionin e siguruar gjate qasjes ne dokumente zyrtare per kete tender prane zyres se prokurimit te KK Prishtine, verejme se OE i propozuar per kontrate ka dorezuar nje Certifikate e cila nuk i ploteson kerkesat e shfaqura ne DT.Certifikata e dorezuar nga OE eshte vetem nje certifikate inspektimi per kualitetin e materialit dhe jo HARDOX Certifikate (HARDOX IN MY BODY), rrjedhimisht nuk ploteson kriterin - pra OE i propozuar per kontrate eshte i papergjegjshem.*
- **Pika 5.** *Ne dokumentacionin e siguruar gjate qasjes ne dokumente zyrtare per kete tender prane zyres se prokurimit te KK Prishtine, nga dokumenatcioni teknik i bashkangjitur nga OE i propozuar per kontrate nuk kemi arritur te verifikojme plotesimin e specifikimeve teknike te kerkuara ne DT si me poshte:*
 - *Per Kamionin 16m3: •The compaction mechanism consists of a sliding and press plate operated by two hydraulic cylinders each installed inside the tailgate. •The hydraulic oil reservoir with a return filter, a filler neck and an oil level indicator with a thermometer is located on the front part of the box and is also in the telescopic cylinder support. •Dual flow hydraulic pump installed directly on the auxiliary drive of the vehicle. •Rear door opening angle minimum 80 degrees. •Automatic activation of the hopper cleaning cycle when the door is fully open. •Waterproof control boxes, IP 67 protection.*
 - *Per kamionin 8m3: •The compacting mechanism consists of a sliding plate and a press plate driven by two hydraulic cylinders located inside the tailgate •Time of one compression cycle - max. 25 seconds”.*

Fillimisht duhet sqaruar se pikat nr. 1, 2 dhe 3 kanë të bëjnë me vizatimin teknik dhe përputhshmërinë e tij me specifikat teknike të detyrueshme. Lidhur me këto pika të pretendimeve ankimore komisioni vlerësues nuk ka gjetur mospërputhshmëri eventuale ndërmjet vizatimit teknik të dorëzuar dhe specifikave teknike të detyrueshme sipas pretendimeve ankimore të parashtruesit. Njëkohësisht as parashtruesi nuk ka arritur që prezantoj prova ose argumente të qëndrueshme përmes të cilave do të mund të vërtetoheshin këto pika të pretendimeve ankimore. Përndryshe sa vet parashtruesi nuk e konteston faktin që vizatimi teknik është dorëzuar me rastin e ofertimit.

Sa i përket pikës nr. 4 dhe 5 të pretendimeve ankimore, komisioni vlerësues përmes raportit të dorëzuar nuk ka evidentuar gjetjet të cilat i pretendon parashtruesit. Përndryshe sa i përket pikës nr. 4 as vet parashtruesi nuk e konteston që është dorëzuar çertifikata HARDOX sikurse është kërkuar me dosjen e tenderit. Ndërsa sa i përket pikës nr. 5 parashtruesi ka thënë se nuk janë evidentuar disa specifika teknike mirëpo nuk ka arritur të paraqesë prova apo argumente mbi të cilat mund të bazoheshin këto pretendime.

Duhet theksuar mbi të gjitha se ky aktivitet i prokurimit tanimë është kthyer në rivlerësim. Kjo nënkupton që të gjitha ofertat e tenderuesve sërish do të ekzaminohen, krahasohen dhe vlerësohen nga komisioni kompetent dhe profesional për rivlerësim.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. lidhur me nenin 62 par. 62.1. të RRPP.

Për pikën III, IV dhe V të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 16.10.2023

Visar SHEHU

Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtroj ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.